

LIBËR

Tani kemi mundësinë dhe gëzimin ta shfletojmë librin mbi Shtëpinë Botuese dhe Shtypshkronjën e "Zojës së Papërlyeme" në Shkodër (1870-1945) të përkthyer edhe në gjuhën shqipe. Nuk është një veprë dosido, e shkruar thjesht nga një i huaj ose nga gjaku ynë i shprishur e për rrjedhojë na duhet t'i përulemi me temena, bash sipas traditës shqiptare të mikpritjes ndaj të huajve, citojmë autorin...

Në promovimin e librit mbi Shtëpinë Botuese dhe Shtypshkronjën e "Zojës së Papërlyeme" në Shkodër (1870-1945)

NGA PROF. BARDHYL DEMIRAJ

Ishte një ditë e veçantë gëzimi, të cilin don të ta ndante edhe me mua ish-doktorandi im Don Markus E. Peters: Do të prezanto hej në Tiranë variantin shqip i tezës së tij të dikurshme të dikurshme të doktoratës mbi shtëpinë botuese dhe njëherësh shtypshkronjën më të vjetër dhe deri sot më jetëgjatë në hapësirën shqiptarë, atë të "Zojës së Papërlyeme" (Shkodër 1870-1945); andaj edhe unë nuk e bëra më të gjatë, por mora avionin me qenë i pranishëm në gëzimin e tij. Që mua më kishin parashikuar edhe të flisja, madje pa më kufizuar në kohë, ishte kjo situatë krejt e papritur. Për më tepër nuk kisha ndonjë dëshirë të veçantë, sidomos kur mësova se prezantimi i parë bëhej në sallën "Aleks Buda" të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë (1 mars 2016). Kishin kaluar do vite, kur në këtë sallë u prezantua dikur një libërthimi me titull "Shqiptar - Albanian" (Naimi 2010) dhe ende nuk më është larguar shija e hidhur e asaj dite, kur një historiani diletant e mori i pari fjalën për diskutim, i alarmuar se nuk ishte cituar emri në bibliografi, ndërkohe që një filolog në pension, i nxituri nga një barsolletë e sapomësuar mbi studimin e elefantëve në shkollat gjermane, franceze, madje edhe ato angleze, u mjaftua të përcille në mexhils kështillat e rastit, se rast se duam të gjejmë vërtet diçka të re për fjalën shqip, këtë duhet "ta kërkojmë në arkivat e Vatikanit". Nëse ky pinjoll i elitës së shteteve intelektuale shqiptare dhe redaktorit përgjegjës i Fjalorit Enciklopedik Shqiptar (Tiranë 2008/9) e ka parë dikur ndonjë derë arkivi nga brenda, është kjo një pyetje në formë përsiatjeje, të cilën lejohej mi ta kalojmë vetëm me buzëqeshje të rastit.

Zullume të kësaj natyre sigurisht që nuk priten asesi të ndodhin, sidomos në atë sallë që mëton të jetë pulti i debatit shkencor-albanologjik në Shqipëri e sidomos kur promovohen vepra autorësh të huaj, nëmos edhe syresh që i takojnë gjakut tonë të prishur. Andaj pranava të marr fjalën, edhe pse kontaktin tim të parë me këtë botim më gjuhën shqipe e pata bash atë çast, kur u hap prezantimi i librit. Pranava sigurisht të flas, sepse besoja dhe besoj të kem qenë i pari ndër tre të parët që e kanë lexuar dhe vlerësuar atë punim në dorë të parë, pikërisht në vitin 2005 kur ishte dorëzuar si tezë disertacioni për të mbrojtur gradën akademike "Doktor në Albanologji" pranë universitetit ndërkohe elitari Ludwig-Maximilian të Munituh. Isha i pari edhe për ndonjë arsye fare të thjeshtë, thuajse triviale: a) ky universitet është i vetmi në veri të Alpeve që ende ofron mbrojtje doktoratash në fushën e albanologjisë si disiplinë komplekse rajonale. E unë jo rastësisht prej 16 vjetësh e drejtoj atë qendër; e b) me Don Markusin më lidhin prej kohësh marrëdhënie miqësive dhe bashkëpunimi të ngushtë. E në rast se unë personalisht mund të kem ndikuar vërtet në mënyrë sado anësore në fiksimin përfundimtar të temës së studimit me rëndësi përkatëse të humlitudin, kjo ka të bëjë thjesht e vetëm punën time mbushamendëse, që këtë projekt ai ta organizonte në mënyrë të tillë, që të ishte i përshatshëm për atë qerthull tematik që mbulon përgjithësisht dega e albanologjisë në atë universitet.

Lidhur me suksesin e kësaj teme mund të përmend fare shkurt, që tre referentët e caktuar për vlerësimin e saj, ndër ta historiani i Shqipërisë prof. Peter Bartl, historiani kompetent për Europën Juglindore prof. Glassel, e së fundi në mbrojtjen e disputacionit edhe prof. Manfred Heim, teolog në po këtë universitet i dhanë këtyri punimi vlerësimin maksimal: summa cum laude. Unë personalisht u bashkova pa kurrfarë mëdysheje këtyri vendimi, se në fund të fundit isha goftë edhe zyrtarisht drejtues i doktoratës së Don Markus E. Peters. Mund të shtoj gjithashtu që m'u desh të kaloja unë i pari nëpër duar materialin e përgatitur për shtyp e që duhej firmosur prej meje, sepse kështu janë rregullat e atyshme për të marrë gradën e doktorit, e cila për Don Markus-in ishte e treta e radhës.

Botimi i tekstit original gjermanisht në plot 700 faqe, në vitin 2007 në shtëpinë e njohur botuese "Kovaç" (Hamburg) ishte pastaj thjesht çështje kohe e radhe botimi dhe u prit vërtet shumë mirë në rrethet shkencore-intelektuale, sikurse e dëshmojnë edhe disa recensione në periodikët përkatës ndërkombëtarë. Nuk mund të kujtoj diçka konkrete për mjedisin intelektual në hapësirën shqiptarë, përpos një interviste të qëlluar të Don Markus-it me gazetaren Elsa Demo, në të cilën u vunë në dukje vlerat kryesore të kësaj veprë.

rrjedhshëm në qëllimin e këtij shkrimi sado të thukët, që s'mund të jetë gjë tjetër veçse një laudatio e këtij botimi të dytë, që ndryshon nga origjinali vetëm sa i përket gjuhës së tekstit të rrjedhshëm, atij shqip.

Titulli i veprës mund të feksë e tingëllojë sot për sytë e veshët tanë si provokues. E kam fjalën të paktën për brezin tim e gjithë ata breza që janë formuar në Shqipëri të paktën deri në kthesën demokratike të viteve 90-të. Nuk kam në fakt informacion se si në ç'mënyrë përcillet sot në periudhën e tranzicionit (edhe) intele-

Në goftë se duam të nxjerrim vërtet diçka pozitive nga ky kontekst i turpshëm që cituam, kjo është pikërisht tematika kryesore e veprës në plot 700 faqe (shqip 760 faqe) me autor Don Markus Peters e që ka të bëjë me aktivitetin e një shtëpie botuese dhe shtypshkronje, e cila si e tillë i ka anashkalluar krejtësisht studimeve të veçanta apo atyre sintezë mbi kulturën shqiptare, përkatësisht asaj të shkrimit shqip bash në Shqipëri gjatë një periudhe më shumë se treqerë shekulli: prej vitit 1870 deri në vitin 1945, kur u mbyll me vendim qeverie, duke iu sekuestruar gjithçka: pasuri e tundshme dhe e patundshme, sikurse edhe vetë Urdhrit Jezuit që mirëmbante këtë shtëpi botuese e shtypshkronjë, i cili u damkos si "urdhër reaksionar dhe antipopullor".

Po ti anashkalojmë goftë edhe përkohësisht përcaktimit në titull si shtëpia botuese "me vjetër në Shqipëri", një vlerësim ky, që mund të ngjallë sadopak konfuzion në njohuritë tona enciklopedike të derisotme, meqë kemi të drejtë të sjellim në debat shtypshkronjën e Voskopojës në shek. XVIII - pra jemi të detyruar ta ngushetojmë vlerësimin vetëm për botimet shqip -, pjesën provokuese në titull lejohej tash ta zolojmë në gjysmën e tij të dytë: "[...] dhe kontributi i saj në Lëvizjen Kombëtare, arsimin dhe kulturën". Me Lëvizje Kombëtare parakuupton sot gjithkush prej nesh Rilindjen Kombëtare Shqiptare, dhe këtë situatë mëton edhe autori i veprës. A kemi të bëjmë vërtet me një realitet kulturor-historik apo me një sakrilegj të mirëfilltë që e mëkaton bash një klerik i sotëm i Kishës Katolike-Romake? Është ky një detaj i tretë që kumton vetë titulli i veprës, duke rritur kështu kuriozitetin e zbrithës drejt e në tekst për të mësuar shumë më shumë për të.

Kemi të bëjmë pra me një temë të re, të bashkëlidhur në tri gjymtyrë të panjohura, përkatësisht tradicionalisht të pamësuar në realitetin intelektual shqiptar të kohës sonë, zhvillimi me sukses i së cilës parakuupton njohuri të thelluara:

a) në zhvillimet historike të Shqipërisë dhe të kulturës shqiptare përgjatë shek. XIX-XX;
b) në veprimtarinë e Urdhrit Jezuit në Shqipëri; të cilën e përcjell më së miri
c) aktiviteti botues i kësaj shtëpie botuese dhe shtypshkronjeje njëherësh.

Thënë troç, një temë e tillë i mirëbesohet vetëm një albanologu-filolog të mirëfilltë, i formuar njëherësh si teolog e që është gjithashtu njohës sqimatar i realitetit historik-kulturor të Veriut katolik shqiptar. Këto tri dhunti i përbush ndërkohe më mirë se kushdo Don Markus Peters, andaj edhe suksesin i gjithë kësaj ndër-marrjeje ishte i predestinuar që në fillim si i tillë.

Dua ta theksoj këtë rrethanë, sepse Peters falënderon në parathënie, ndër të tjerë edhe personin tim, si drejtues i temës së tij. Por të shkruash më parë dy tema doktorate: a) në historinë e artit dhe b) në teologjinë katolike-romake, sigurisht që s'ke fare nevojë për një drejtues të një teme të tretë. Unë vetë e kam konsideruar vetveten gjithëherë si bashkëbesues në punën e tij e si të tillë kemi diskutuar së bashku çështje ndër më të ndryshmet që kishin të bënin me njëherë ose tjetër dhunti të përmendur më lart. Të dy "i kemi dhënë mend" njëri-tjetrit, pa cenuar aspak konceptimin si edhe perspektivën e hetimit individual të njërës ose tjetrës çështje.

Kështu p.sh. gjatë diskutimit lidhur me punën e parë përgatitore të shfrytëzimit dhe seleksionimit të materialit studimor dhe dokumentar-arkivor doli në pah se ç'do punë e madhe e priste "Shën Pjetrin në mangall", meqë po



Promovimi i librit mbi Shtëpinë Botuese dhe Shtypshkronjën e "Zojës së Papërlyeme" në Shkodër

Kemi të bëjmë me një shtëpi me 725 tituj

Kemi të bëjmë me një shtëpi botuese, për të cilën Peters regjistron shifrën për atë kohë marramendëse me plot 725 tituj, në të cilën as më shumë e as më pak por plot 38% rezultojnë të ketë qenë letërsi e mirëfilltë e formimit fetar, që u takon kryesisht botimeve katekistike, historisë së fesë së krishterë dhe praktikës teologjike. Më shumë se 52% i takojnë përkundrazit librave mësimorë në shkencat humane dhe ato të natyrës, formimit të përgjithshëm intelektual e sigurisht edhe kërkimit albanologjik.

Tash kemi mundësinë dhe gëzimin ta shfletojmë këtë veprë edhe të përkthyer në gjuhën shqipe. Nuk është një veprë dosido, e shkruar thjesht nga një i huaj ose nga gjaku ynë i shprishur e për rrjedhojë na duhet t'i përulemi me temena, bash sipas traditës shqiptare të mikpritjes ndaj të huajve. Pra nuk është si sa e sa vepër historike-albanologjike që mbajnë firmën e diletantizmit intelektual të kohës sonë e që shërbejnë vetëm për të na shtuar krenarinë e castit, se sa të lashtë jemi në shqiptarët e çfarë bëmas kanë korrur e përjetuar atëbotë të parët tanë: sipas rastit piratë ilirë, pushtues maqedonas e piratë apo pellazgë të mjegullt. Ajo çka të bie së pari në sy për mirë, është që botimin shqip të kësaj veprë në plot 760 faqe e kishte marrë përsipër si institucion Urdhri Jezuit në Shqipëri dhe se përkthimin e ka realizuar Edmond Malaj, që është jo thjesht dhe vetëm njohës i mirë i gjermanishtes dhe kulturës së shkrimit shqip, por edhe studiosi i spikatur i historisë së Mesjetës, sidomos për Arealin Kulturor të Veriut e për më tepër me studime solide në fushën e teologjisë në Universitetin e Graz-it në Austri.

Më duhet t'i theksoj këto fakte për të ravigëzuar atë kuadër ndërdisiplinor që rrok në tërësinë e vet tematika e kësaj veprë, që mban një titull të thjeshtë, por të gjatë dhe po aq domethënës: "Shtëpia botuese më e vjetër e Shqipërisë dhe kontributi i saj për Lëvizjen Kombëtare, arsimin dhe kulturën" e me nëntitull: "Tipografia e Zojës së Papërlyeme në Shkodër (1870-1945)" (Tiranë 2016) Kështu, po kaloj



kuadër ndërdisiplinor që rrok në tërësinë e vet tematika e kësaj veprë, që mban një titull të thjeshtë, por të gjatë dhe po aq domethënës: "Shtëpia botuese më e vjetër e Shqipërisë dhe kontributi i saj për Lëvizjen Kombëtare, arsimin dhe kulturën" e me nëntitull: "Tipografia e Zojës së Papërlyeme në Shkodër (1870-1945)" (Tiranë 2016) Kështu, po kaloj

